



ACCURA LAW OFFICE

STATUTI SHOQËRISË SË THJESHTË “ACCURA LAW OFFICE”

Sot në Shkodër, me date 3 janar 2024, Anetarët Themelues:

- 1. Z. Anton Kosteri**, i biri i Gjon dhe i Tone, lindur më 22.01.1988 në Shkodër dhe banues në Shkodër, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotesi të plotë juridike për të vepruar, me numër personal: I80122078M.
- 2. Znj. Edit Gyrçari**, e bija e Selahedin dhe e Myrvete, lindur më 23.02.1990 në Shkodër dhe banuese në Shkodër, me shtetësi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me me numër personal; J05223108D.

Të dy së bashku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi, ranë dakort për krijimin e shoqërisë së thjeshtë “*Accura Law Office*” me kushtet e mëposhtme.

Të dy se bashku, bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Kodin Civil, kane hartuar me poshte si vijon Statutin e Shoqërisë “*Accura Law Office*”, të cilët e kane themeluar ne bazë të kontratës së themelimit.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon poziten juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, dhe organeve të saj, llojin e partneritetit, kohezgjatjen e veprimtarisë së saj, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria e thjeshtë do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Ofrimin e shërbimeve avokatore, duke përfshirë por pa u kufizuar në: Perfaqesim në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tre kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombetare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe perfaqesimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit;
- Dhënie ndihme juridike e ndërmjetësime për zgjidhje juridike me mirekuptim e jashtëgjyqësisht të konflikteve tënaryrave të ndryshme;
- Dhënie ndihmë juridike për negocimin, hartimin, lidhjen dhe zbatimin e kontrarave civile, tregtare, administrative, dhe për veprime të tjera juridike.

- Ofrimin e çdo lloj konsulence të personal fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj, publike dhe/ose private si shoqeri tregtare, organizatat tregtare qeveritare, organizatat jo fitimprurëse, fondacionet, institucionet shtetërore, ministrite, departamentet qeveritare dhe autoritetet publike dhe në veçanti, konsulence në lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun, konsulence për taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerëzore dhe konsulencë e përgjithshme për shoqëritë që veprojnë në sektoret e biznesit dhe të industrisë brenda kufizimeve të pashikuara në ligj parashikuara në ligj.
- Vlerësimin e zhvillimeve të tregut brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme të informimit për personat juridike dhe fizike të interesuar, vendas dhe të huaj, ashtu siç mund të kërkohet prej tyre.
- Konsulencë për administrimin, shitblerjen, dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industriale, publike apo private, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndërmjetësim për kryerjen e veprimeve të mesiperme midis personave juridike private apo publike, vendas apo të huaj dhe personave fizike, marketing, ekspertize shitje, menaxhim prone.
- Organizimin e kurseve trajnuese për studentët e rinj apo përsonave të tjerë të interesuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ofrimin e leksioneve dhe mbështetjen me materiale ndihmëse e plotësuese të kurrikulave mesimore
- Kryerjen e sondazheve në fushën e së drejtës në zbatim të projekteve të ndryshme.
- Kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose jo me permbushjen e objektit të sipërpermendur të shoqërisë.....

NENI 2 EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë së thjeshtë është “Accura Law Office”, me poshte referuar si “Shoqëria”

NENI 3 SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga: “Don Bosko”, kati i II-të, Shkodër, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 4 REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË




Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka qëllim midis tjerave fitimin.

Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë së Thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Kontratës së Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi.

Me vendim unanim të mbledhjes së Anëtarëve Themelues, shoqëria mund të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Kontratës së Themelimit dhe Statutit të saj, duke bërë përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatëse.

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTAREVE THEMELUES

Anetarët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.

Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Anëtarëve në raport me kapitalin themeltar të investuar. Pasuritë e shoqërisë mund të tjetërsohen, jepen me qira dhe të lihen peng në hipoteke me miratimin e Mbledhjes së Anëtarëve Themelues.

NENI 6

KOMPETENCAT E ANEËTARAVE

Anetarët ndër të tjera kanë të drejtat e mëposhtme:

Miratojnë Bilancin vjetor të shoqërisë.

Vendosin për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.

Emërojnë dhe revokon Administratorin e shoqërisë.

Kryejnë modifikime në statusin sipas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.

Vendosin për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.

Anetarët në përputhje me Kontraten e Themelimit, me Statutin dhe legjislacionin në fuqi kanë të drejtë të zotërojnë kuota aksione edhe në Shoqëri të tjera, të thjeshta apo tregtare tregtare.

Anetarët kanë të drejtë emërojnë ose shkarkojnë Administratorin e Shoqërisë apo të punësuarit.

NENI 7

DETYRIMET E ANETAREVE

Anëtarët kanë nder të tjera detyrime si me poshte:



Anetarët Themelues detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë.

Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të shoqërisë.

Të sigurojnë mundësinë e specializimit të personelit gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë së veprimtarisë së ushtruar

NENI 8 KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria e thjeshtë "Accura Law Office" do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohore të pakufizuar.

NENI 9 KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQËRISË

Aktiviteti operues i Shoqërisë bazohet nëparimet e ekonomisë së tregut.

Veprimtaria ekonomike dokumentohet mbi parimet e kontabilitetit dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

NENI 10 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anetareve themelues në vlerën 1000 (një mijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga anetarët themelues në këtë mënyrë:

1. Z. Anton Kosteri në rrasen 60% të vlerës së kapitalit themeltar.
2. Znj. Edit Gyrçari në rrasen 40% të vlerës së kapitalit themeltar.

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga anëtarët themelues me rastin e themelimit kësaj shoqërie dhe nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi, dhe është nënshkruar prej tyre pa rezerva

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij, janë të transferueshme si ndërmjet anëtarëve themelues ashtu edhe përkundrejt personave të tretë.

Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të anëtarëve themelues dhe me akt noterial.

Në qoftë se njëri nga anëtarët themelues dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga anëtarët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij një subjekti tjetër.

Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga anëtarët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë i caktuar nga anëtarët.

NENI 11 ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Anetareve, e cila mbledhet në çdo kohë kur Administratori apo vetë Anetaret e kërkojnë.

Anetaret me marrëveshje në përputhje me nenin 1080 të Kodit Civil bien dakord se Administratimi i Shoqërisë do të kryhet nga një Administrator, i cili do të vepronte i vetëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretet si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

Administratori emërohet apo shkarkohet me vendim të gjithë Anetareve.

Personi i mëposhtem emërohet Administrator i Shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rimerimi: **Z. Anton Kosteri**, i biri i Gjon dhe i Tone, lindur më 22.01.1988 në Shkodër dhe banues në Shkodër, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër personal.

NENI 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori.

Administratori ka ndër të tjera kompetencat si më poshtë:

- Te përcaktojë strukturën organizative të shoqërisë
- Te miratojë planin e veprimtarisë së shoqërisë
- Te miratojë pasqyrat financiare të shoqërisë

NENI 13 VITI FINANCIAR, PASQYRAT VJETORE FINANCIARE

Viti financiar i shoqërisë zgjat 12 dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të vitit. Viti i parë i shoqërisë fillon në datën e regjistrimit dhe mbaron në datën e 31 Dhjetorit.

Në fund të vitit financiar, administrator do të përmbushë detyrat e mëposhtme:

Përgatitjen e listës së asetëve të shoqërisë

Përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të shoqërisë

NENI 14 FITIMI I SHOQËRISË



Fitim i Shoqërise do të shpërndahej në përputhje me pjesët takuese të kapitalit të Anëtarëve të saj.

NENI 15 MBYLLJA E SHOQËRISË LIKUIDIMI

Shoqëria mund të japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Anëtarëve Themelues.

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likuidimit në të cilin paraqet bilancin e likuidimit.

Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes anëtarëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themelues.

Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarit të saj.

NENI 16 TË PERGJITHSHME

Në rast të lindjes së mosmarrëveshjeve për këtë kontratë që ka vlerën e aktit të themelimit të shoqërisë, do të zgjidhen nga vetë anëtarët themelues me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Seksioni Civil i Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

ANËTARËT

Anton Bastari

[Signature]

Edi Gjykan
[Signature]